



VENDIM

Nr. 60, Datë 29.04.2016

**MBI
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E DRAFT -
RREGULLORES PËR LIDHJET E REJA NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES**

Në mbështetje të nenit 16, 27 pika 3, 108 dhe 110 të Ligjit 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, nenit 25 të “Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s” miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, si dhe Kodit të Shpërndarjes të miratuar me vendimin nr. 100, date 26.8.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.04.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e paraqitur për fillimin e proçedurave për shqyrtimin e draft-rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes,

Konstatohet se :

- Me shkresën nr. 5831/1, Prot 25.03.2016 dhe nr. 278 Prot Hyrës, datë 29.03.2016, subjekti OSHEE sh.a, ka propozuar ‘Draftin me ndryshimet e kërkuara në rregulloren e lidhjeve të reja për të shkurtuar punën normale të OSHEE-se në garantimin e pa ndërprerë të energjisë elektrike dhe parametrave teknikë të saj’.
- Nga rekomandimet e grupit ndër-institucional për vlerësimin, përmirësimin dhe monitorimin e indikatorëve të ‘Doing Business’, të ngritur me urdhër të Këshillit të Ministrave Nr. 30, datë 30.01.2014, me këtë draft parashtrohet lehtësimi i proçedurave për furnizimin me energji elektrike të objekteve veçanërisht të bizneseve.
- Mbështetur në “Rregullat e Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s”, ERE shprehet me vendim për fillimin e procedurës për shqyrtimin e draftit të propozuar.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Fillimin e proçedurave për shqyrtimin e draft-rregullores për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes.

2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit AHMETI